



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 32, datë 01/07/2004

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE
KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS SË QËNDRËS EKONOMIKE
TË ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2004 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “ç”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.14, dt.10/03/2004 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë Rregulloren “Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve për detajimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI